



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 27 Janar 2022

Nr: 8

V E N D I M

P Ë R

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 02, DATË 22.01.2022, TË KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR MIRATIMIN E DISA AFATEVE PROCEDURALE QË LIDHEN ME ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR, DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJË, QË DO TË ZHVILLOHEN MË DATË 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, neni 20, pika 1, shkronja “a”, neni 6, neni 29, pika 6, neni 36, pika 2, neni 64, neni 65, neni 67, pika 1, neni 70 dhe neni 94, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e një anëtari të Komisionit Rregullator

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 2, datë 22.01.2022, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 më këtë përmbajtje:  
“1/1. Autoriteti i Mediave Audio dhe Audiovizive monitoron OSHMA-të për veprimtaritë me karakter publik të institucioneve publike të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga data 31 Janar 2022, nga ora 08:00-00:00 ose sipas rastit deri në përfundimin e programit.”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO - Kryetare**

**Arens ÇELA - Anëtar**

**Dritan ÇAKA - Anëtar**

**Helga VUKAJ - Anëtare**

**Muharrem ÇAKAJ - Anëtar**



Data: 27 Janar 2022

Nr. 8

“Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”